



Viti i X-të i Botimit, Nr.2,
Dhjetor 2019

“FJALOR SHPJEGUES I PSIKANALIZËS” I PAJAZIT NUSHIT (REÇENSË)

Vilma Proko*

*Akademia e Studimeve Albanologjike, Qendra e Botimeve Enciklopedike, Tiranë

Adresë kontakti: vilmaproko67@gmail.com

Përmbledhje

Kur para 9 vjetësh u botua Fjalori shpjegues i psikanalizës i akademik Pajazit Nushi, me 343 faqe, ai u prit me interes të veçantë. Nuk ishin vetëm arsyet e thjeshta gjuhësore e jashtëgjuhësore pse u bë i tillë: ai u bë i tillë edhe për arsyen pse shprehte punën shumë serioze e me përkushtim të rrallë profesional e shkencor të hartuesit të tij, emër i shquar në psikologjinë dhe terminologjinë shqiptare. Botimi për herë të parë në shqip përbën një ndërmarrje serioze shkencore e profesionale, me rëndësi të shumëfishtë për kulturën tonë në përgjithësi.

Është e vërtetë se leksikografia shqipe ka kapërcyer rrugë të gjatë në periferi të Europës, por me arritje që meritojnë vëmendjen. Fjalori shpjegues i psikanalizës është ngritur mbi një trashëgimi të pasur botërore fjalorësh të këtij lloji dhe këtë e ka arritur suksesshëm. Duke qenë i tillë, ai pashmangshëm përcjell zhvillimin e shumanshëm të psikanalizës botërore, por ndërkaq mund të shihet edhe si një përmasë historike e shqipes për një periudhë të caktuar kohore. Në këtë kontekst mund të thuhet se terminologjia shqipe e psikanalizës është pasuruar dukshëm në sasi e në cilësi.

Ky botim në të vërtetë ka përfshirë disa ndryshime e përmirësime, në rend të parë, sa i përket korpusit të fjalorit, i cili është pasuruar dukshëm, sepse krahasuar me botimin e mëparshëm gjuha ka pësuar ndryshime dhe leksiku i saj është pasuruar në mënyrë thelbësore nga shumë anë.

Fjalë çelës: *fjalor shpjegues, psikanalizë, gjuhës shqipe, rëndësi, vlera.*

“EXPLANATORY DICTIONARY OF PSYCHOANALYSIS” BY PAJAZIT NUSHI

Abstract

When the dictionary of psychoanalysis by Academic Pajazit Nushi was published 9 years ago, with 343 pages, it was received with special interest. It was not just the linguistic and extra-linguistic reasons why it did so: it did so because it expressed the very serious and rare professional and scientific devotion of its compiler, a prominent name in Albanian psychology and terminology. Publishing for the first time in Albanian is a serious scientific and professional enterprise, of multiple importance to our culture in general.

It is true that Albanian lexicography has come a long way on the outskirts of Europe, but with remarkable achievements. The explanatory vocabulary of psychoanalysis is built on a rich world heritage of dictionaries of this kind and has achieved this successfully. As such, it inevitably follows the multifaceted development of world psychoanalysis, but can also be seen as a historical dimension of Albanian for a given period of time. In this context, it can be said that the Albanian terminology of psychoanalysis has been significantly enriched in quantity and quality.

This edition has actually included some changes and improvements, first and foremost, in terms of lexical corpus, which has been significantly enriched because, compared to the previous edition, the language has undergone changes and its lexicon has been substantially enriched.

Keywords: *explanatory dictionary, psychoanalysis, Albanian language, importance, value.*

1. Veçori të përkthimit heterogjen të mendimeve psikanalitike të veprave të Z. Frojdit, A. Adlerit, K. Jungut, E. Fromit etj.

Veprat e Zigmund Frojdit, të përkthyera në shumë gjuhë, u përkthyen edhe në gjuhën shqipe në vitet e fundit të shekullit të njëzetë dhe në fillim të shekullit të njëzetënjëtë. Përkthimi është kryer sipas rëndësisë së tyre për zhvillimin e mendimit psikanalitik ndër shqipfolësit. Veprat e përkthyera në gjuhën shqipe u bënë njëkohësisht burim i rëndësishëm për zhvillimin e mendimit shkencor të disa disiplinave të shkencave sociale, sidomos asaj të psikologjisë dhe të psikiatrisë. Përkthimi në shqipe i këtyre veprave ka disa karakteristika.

- Ritmi i përkthimit në shqip i këtyre veprave është në raport shpërfillës me zhvillimin e mendimit psikanalitik ndër shqiptarët. Fillesat e mendimit psikanalitik ndër shqiptarët janë të lidhura me zhvillimin e mendimit psikologjik, sociologjik dhe me krijimtarinë letrare të shqiptarëve të Shqipërisë së viteve të hershme të shekullit të njëzetë.

Përkthimi i veprave të psikanalizës së Z. Frojdit e ka zanafillën qysh më 1938, por u ndërpre gjatë Luftës II Botërore, e në vijim nga qëndrimi shpërfillës i psikanalizës në sistemin monist, kur qëndrimet politike dhe ideologjike u shndërruan në doktrinë antipsikanalitike. Pas rënies së sistemit monist mendimi psikanalitik u rishfaq, pësoi ndryshime dhe plotësime varësisht nga konteksti ideologjik, historik dhe kulturor i shqiptarëve në Shqipëri, në ish-Jugosllavi dhe diasporë.

Përkthimi i veprave të psikanalizës në shqipe mori hov pas vitit 1990 e deri nga fundi i shekullit të njëzetë u përkthyen kapitujt më të rëndësishëm të veprave të Z. Frojdit dhe u botuan në formë broshurash, duke punuar në të njëjtën kohë edhe në përgatitjen për botim integral të këtyre kapitujve në libra të veçantë. Përkthimi intensiv i këtyre veprave u bë brenda një kohe relativisht të shkurtër nga disa përkthyes, kryesisht gjuhëtarë, njohës të gjuhës burimore të veprave dhe të gjuhës shqipe, në mungesë të një fjalori të këtij lloji, e për më tepër në mungesë të leksikonit të psikanalizës në gjuhën shqipe. U shqipëruan edhe një varg termash latinisht të psikanalizës. Natyrisht, termat burimorë të psikanalizës, si edhe ata nga psikopatologjia e psikiatria, kanë ngelur edhe në shqip në trajtën e gjuhës burimore të tyre.

Në përpjekjet e përkthyesve për të gjetur termin e duhur në shqip për konceptet psikanalitike janë bërë lëshime dhe gabime. Ndër këto ka edhe përkthime të gabuara në shqip të termave të koncepteve themelore të teorisë së psikanalizës, të cilat u reflektuan në shpjegime të errëta të përmbajtjes së teorisë së psikanalizës, në shpjegimin e zhvillimit të dukurive, të proceseve dhe të formave të shumëllojshme të sjelljeve normale dhe jonormale të njeriut.

Përvojat e përkthimit të veprave të Z. Frojdit në gjuhë të tjera kanë treguar se përkthimin e mirë mund ta bëjnë gjuhëtarët njohës të denjë të mendimit psikanalitik, ose psikanalistët njohës të denjë të gjuhës burimore të psikanalizës dhe të gjuhës së huaj.

Konceptet themelore të psikanalizës dhe termat e tyre janë paraqitur në trajta emërtuese të ndryshme edhe në “Hyrje në Psikanalizë”, që konsiderohet si një nga veprat kryesore të psikanalizës.

2. Literatura psikanalitike dhe fjalori shpjegues i psikanalizës në gjuhën shqipe

Siç dihet, psikanaliza dhe mendimi psikanalitik në përgjithësi ka qenë mendim me ndikim të fuqishëm në psikiatrinë dinamike, në psikologjinë dinamike dhe në procesin e krijimtarisë në kulturë dhe në art. Ndikimi i mendimit psikanalitik i të pavetëdijshmes ka qenë i fuqishëm sidomos

ndërmjet Luftës I Botërore dhe Luftës II Botërore, por edhe pas përfundimit të tyre. Gjatë kësaj kohe u botuan 24 veprat e Z. Frojdit, veprat e disidentëve të tij, përkatësisht ato të Karl Jungut dhe të Alfred Adlerit, por edhe e shumë psikanalitikëve të tjerë në shumë shtete të Europës, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, etj. U botuan dhe u ribotuan disa herë kompletet e veprave të tyre. Përkthimi në shqip i veprave të Z. Frojdit ka filluar më 1938 me “Pesë leksione të psikanalizës” nga sociologu dhe mendimtari shqiptar Branko Merxhani.^[1] U ndie ndikimi i psikanalizës edhe në krijimtarinë letrare të shqiptarëve (Vangjel Koça, Ernest Koliqi, Nonda Bulka, etj.). Veprimtaria në përhapjen e mendimit psikanalitik ndër shqiptarët u ndërpre në vitet e Luftës II Botërore, kurse pas saj sistemi monist, sidomos ai në Shqipëri, pati qëndrim negativ ndaj Z. Frojdit e sistemit psikanalitik, dhe për këtë shkak në Shqipëri psikanaliza ishte e ndaluar. Mirëpo nga vitet ‘90 të shekullit XX, filloi përkthimi i veprave psikanalitike dhe botimi i tyre në gjuhën shqipe. Citoj autorin: “...u themelua “Biblioteka e psikanalizës”^[2] në gjuhën shqipe”. Gjatë viteve të fundit të shekullit XX dhe në fillim të shekullit XXI u përkthyen dhe u botuan në shqip numri më i madh i veprave të psikanalizës dhe të neopsikanalizës. Nga vitet ‘30 të shek. XX u botuan disa fjalorë të psikanalizës, nga të cilët përmenden fjalori i Dr. R. Shterba “Handvorterbuch der Psychoanalyse” - “Fjalori doracak i psikanalizës”, Ndërkaq, në frëngjisht u hartuan disa fjalorë të psikanalizës, ndër të cilët dallohen “Vocabulaire de la Psychoanalyse”, me autorë J. Laplanche e J. - B. Pontalis”, i përkthyer edhe në gjermanisht, më pas u botua “Dictionnaire de la Psychoanalyse”, të autorëve Elisabeth Roudinesco et Michel Plon prej 1222 faqesh të formatit të madh, që u përkthye në disa gjuhë. U botuan edhe “Glosary of Psychoanalytic Terms and Concepts”, si edhe “Encyclopedia of Psychoanalysis”, etj. Këto botime leksikografike dhe enciklopedike treguan për ekzistencën e një terminologjie të qëndrueshme, por pak të njohur në gjuhën shqipe dhe në trevat shqiptare, pa ndonjë traditë në zbatimin dhe përdorimin e psikanalizës dhe të mendimit psikanalitik. Fjalorët e psikiatrisë, të psikologjisë, të filozofisë, të sociologjisë, të pedagogjisë^[3], etj., në gjuhën shqipe përmbajnë edhe terma të psikanalizës të përzgjedhur sipas nevojës së lëndës së tyre. Për të gjitha këto shkaqe hartimi shqip i fjalorit të psikanalizës ishte një domosdoshmëri, madje për zhvillimin e mendimit psikologjik, psikiatrik e sociologjik.

3. Vlerësime mbi përmbajtjen e “Fjalor shpjegues i psikanalizës” të Pajazit Nushit

“Fjalori shpjegues i psikanalizës” (FSHP) është fjalor gjithëpërfshirës, sepse në këtë Fjalor janë përpunuar dhe janë shpjeguar hollësisht të gjitha termat e koncepteve psikanalitike dhe sistemi i këtyre termave. Në hartimin e termave të këtij fjalori autori ka konsultuar jo vetëm literaturën e gjerë të psikanalizës, por ka konsultuar në mënyra të ndryshme ekspertë nga fusha e biologjisë, e gjuhësisë, e fiziologjisë, e pedagogjisë, e psikiatrisë, e psikologjisë, e sociologjisë,

etj. Termat shqip të psikanalizës, siç përmendëm, janë nxjerrë drejtpërdrejt nga literatura e gjerë e psikanalizës, duke përfshirë në rend të parë fondin e përkthyer në gjuhën shqipe të librave të Z. Frojdit. Të cituarit e literaturës prej nga është nxjerrë termi i caktuar i psikanalizës me të gjithë elementet përcaktuese të saj, është përmasë origjinale e këtij fjalori. Termat, shpjegimi domethënies dhe i burimeve gjuhësore dhe semantike të tyre do të mundësojnë kuptimin e teorisë së psikanalizës dhe të metapsikologjisë së ndërlikuar. Termat e koncepteve kognitive, por edhe termat e nocioneve apo koncepteve të ndjenjave dhe të psikodinamikës, që kanë dendurinë më të madhe në terminologjinë e psikanalizës, si edhe rëndësinë e veçantë të tyre, janë përshkruar dhe shpjeguar në mënyrë të shkoqitur duke përcaktuar hollësisht kufirin domethënës ndërmjet tyre. Numri më i madh i termave ka bazë gjuhësore të shqipes dhe vetëm një numër i kufizuar termash, sidomos ato me origjinë nga latinishtja dhe greqishtja e vjetër, kanë ruajtur burimin nga gjuhët e huaja. Fjalitë përmbledhëse dhe të qarta për konceptet apo nocionet e proceseve psikike dhe të sjelljeve të njeriut për specialistët (psikiatër, psikologë, sociologë, etj.), si edhe për publikun e gjerë e bëjnë këtë fjalor pjesë përbërëse të leximit me kuptim të veprave të psikanalizës dhe të atyre veprave të fushave të tjera që ndërliken me mendimin psikanalitik. Për këto shkaqe “Fjalori shpjegues i psikanalizës” ka rëndësi teorike dhe praktike. Përgjithësisht, mund të thuhet se ky fjalor është një pasuri leksikografike e shqipes me rëndësi të posaçme, me vite të gjata pune, në një veprimtari psikologjike e gjuhësore-terminologjike.

Është e vërtetë se leksikografia shqipe ka kryer rrugë të gjatë në periferi të Europës, po brenda rrjedhave të saj, me prapambetjet e mangësitë e skajeve, por me arritje që meritojnë vëmendjen. FSHP është ngritur mbi një trashëgimi të pasur përkthimesh nga pothuaj të gjitha veprat e Z. Frojdit të disa psikanalistëve dhe neopsikanalistëve të tjerë. Veç kësaj, ai mbështetet edhe në fjalorët më të njohur të leksikografisë botërore të këtij lloji. FSHP duhet të japë pamjen, fizionominë, e gjuhës standarde shqipe dhe këtë e ka arritur suksesshëm. Duke qenë i tillë ai pashmangshëm përcjell zhvillimin e shumanshëm të shoqërisë shqiptare në të gjitha përmasat e jetës së saj. Pasurimi, përpunimi dhe plotësimi i tij, që na ofrohet sot, duhet të shihet nga ky këndvështrim. FSHP mund të shihet edhe si një përmasë historike e shqipes për një periudhë të caktuar kohore. Në këtë kontekst mund të thuhet se ky fjalor dëshmon se shqipja është pasuruar dukshëm në sasi e në cilësi.

Makrostruktura. Sa i përket makrostrukturës, hartuesi i fjalorit ka vepruar si duhet jo vetëm lidhur me përzgjedhjen e fjalësit aktiv, fjalësit pasiv dhe atij potencial, po edhe me renditjen e njësisive, si dhe me përdallimin e tyre në mbështetje të marrëdhënieve semantike që krijohen midis tyre. Përfshirja e fjalëve të reja, fjalëve pak të njohura, përfshirja e një numri fjalësh të huaja me karakter ndërkombëtar, si dhe përfshirja e një vargu termash në mbështetje të rolit të tyre shoqëror, terma të cilët kanë fituar qytetarinë në një rreth të gjerë të shqipfolësve – i japin këtij fjalori

karakter sinkronik.

Mikrostruktura. Sa i përket mikrostrukturës mund të thuhet se të gjitha informacionet kanë strukturë të qëndrueshme dhe e shquan parimësinë në këtë anë, duke filluar nga njësia leksikografike e deri te shpjegimi me shembuj. Ajo që e bën të vlefshëm një fjalor është saktësia. Fjalori nga kjo anë ka meritë të veçantë. Sot, në leksikografinë bashkëkohore ka një ekonomi që drejton fjalorët, prandaj saktësia, ngjeshja dhe shkurtësia – janë veçoritë kryesore që do të duhej të shoqëronin një fjalor. Të gjitha këto kritere dhe të tjerat, që nuk përmenden, janë plotësuar në shkallë të lartë nga FSHP. Si i tillë ai mban me plot të drejtë epitetin fjalor bashkëkohor.

Vlera të tjera të “Fjalor shpjegues i psikaanalizës”

“Fjalor shpjegues i psikanalizës” me 344 faqe është fjalor i tipit të vogël që ngërthen një termës me rreth 428 terma psikanalitikë. Termat e koncepteve të psikanalizës janë renditur sipas alfabetit të gjuhës shqipe. Përpunimi i termave është mbështetur në këto parime:

1. Termat e nocioneve psikanalitike janë nxjerrë nga një literaturë e gjerë e psikanalizës e shtjelluar në shumë vepra të themeluesit të psikanalizës Zigmund Frojd.
2. Autori ka bërë krahasimin e termave të veprave të përkthyer në gjuhën shqipe me të njëjtat të shkruara në gjermanisht dhe në kroatisht. Nga ky krahasim ka përpiluar regjistrin e termave të psikanalizës në shqipe dhe të njëjtat i ka përpunuar dhe paraqitur në një trajtë karakteristike.
3. Është dhënë përkufizimi analitik-sintetik i nocioneve psikanalitike dhe përkufizimet e nocioneve janë shkruar me shkronja më të dallueshme nga pikëpamja grafike dhe me ngjyrë të theksuar.
4. Pas përkufizimeve të këtyre të nocioneve është shtjelluar gjerësisht domethënia e secilit term dhe argumentimi i domethënies të këtyre është nxjerrë nga literature e gjerë, e cila është cituar dhe është shënuar për secilin term me shenjat grafike a1, a2, a3, etj. Shtjellimet e nocioneve janë paraqitur me grafi të shkronjave “kursive”.
5. Termat kryesorë të psikanalizës janë shtjelluar gjerësisht, kurse termat e derivuar nga ato kryesorë janë shtjelluar më ngushtë, duke iu referuar domethënies së termave kryesorë, etj.
6. Arritje e *Fjalorit* është dhe bashkëkohësia e termës. Në vitin 1987 u botua nga Instituti Albanologjik i Prishtinës ““Fjalor i psikologjisë”^[4], që përfshinte termat themelore të psikologjisë. Ndërsa “Fjalori shpjegues i psikanalizës” është përqendruar në përzgjedhjen dhe dhënien e një terminologjie për të gjitha nëndegët e psikologjisë. Simetria e termave për këto nëndegë, të pasqyruar në vepër, e rrit cilësinë e saj.

7. Përcaktimi i terminologjisë shqipe dhe ballafaqimi gjuhësor i saj me gjuhët që kanë sisteme të standardizuara në këtë fushë (me anglishten, me gjermanishten, me frëngjishten dhe me serbokroatishten) ka qenë synimi kryesor i autorit të këtij *Fjalori*. Duke parë realizimin dhe cilësinë e tij, mund të themi se autori e ka arritur këtë synim.

Përkrahja e fjalës shqipe dhe shqipërimi i një numri sa më të madh termash, përsëri ka qenë një prej synimeve kryesore të përpunimit dhe të kodifikimit të terminologjisë së psikanalizës. Hartuesi ka treguar edhe njëherë se gjuha shqipe i ka mundësitë dhe aftësitë për të krijuar terma të psikanalizës në gjithë llojshmërinë e tyre. Në *Fjalor* gjejmë edhe terma të huaj, por këto më të shumtën janë ndërkombëtarizma^[5].

Struktura përmbajtjesore e termave

Termet e përpunuar dhe të paraqitur sipas parimeve të lartpërmendura kanë këto përmbajtje të psikanalizës: a) Psikanaliza - metodë klinike gjurmuese, dhe b) Psikanaliza - teori e personalitetit me termat e koncepteve metapsikologjike të saj. Lidhur me këtë mënyrë të shtjellimit të termave dhe të kuptimit të tyre autori ka përfshirë historinë e zhvillimit të mendimit psikanalitik^[6], duke përpunuar zhvillimin e këtij mendimi dhe historinë e tij edhe ndër Shqiptarët para Luftës II Botërore, pas kësaj Luftë, pikërisht në sistemin monist në Shqipëri, në Kosovë e në vende të tjera të banuara prej Shqiptarëve. Janë terminologjizuar edhe rastet më të njohura të kurimit dhe të shërimit të pacientëve në bazë të metodës psikanalitike (“Dora”, “Hansi i Vogël”, “Mozer Fani” etj.). Po ashtu, janë terminologjizuar edhe organizatat psikanalitike kombëtare dhe ndërkombëtare. Është shtjelluar edhe zëri “Terminologjia e psikanalizës”, ku autori jep në mënyrë të thukët zhvillimin e kufizuar të saj në gjuhën shqipe. Nga krahasimi i veprave të përkthyer në shqip të Frojdit me të njëjtat në gjuhën origjinale dhe të përkthyer në gjuhë të tjera, autori ka konstatuar përdorim jo të saktë termash për kuptimin psikanalitik të tyre. Meqë mendimin psikanalitik e karakterizon në rend të parë dinamika e personalitetit, si edhe struktura e zhvillimi i tij autori ka hasur në disa terma kyç të përkthyer gabimisht. I tillë është termi qendror i psikanalizës “*shtytës*” (“*trieb*” në gjermanisht, “*drive*” në anglisht, “*pulsion*” në frëngjisht, “*vlacenije*” në rusisht, “*nagon*” në kroatisht etj.). Disa terma të përkthyer në shqip nga veprat e Frojdit dhe të psikanalistëve të tjerë, si *paravetëdije*, *vetëdije*, *i (e) pavetëdijshëm*, *ndërgjegje* etj., kanë kuptime të ndryshme, dhe herë-herë kanë zëvendësuar njëri-tjetrin. Nga kjo strukturë e përpunimit të termave del në pah se në këtë fjalor është përfshirë brumi i psikanalizës dhe është saktësuar kuptimi i termave shqip të psikanalizës.

5. Veçori të tjera

Strukturimi i *Fjalorit* i është përgjigjur përdorimit të lehtë të tij: *Parathënia* e shkurtër në shqip; *Hyrja*, *Regjistër i termave kryesorë të psikanalizës*, *Shkurtesat dhe emërtimi i plotë i tyre*, *Falënderime*, *Teksti themelor*, *Indeksi i termave* dhe *Literatura* krijojnë mundësi të reja për standardizimin e terminologjisë së psikanalizës, pra përdorimin pa mëdyshje të termave të pranuar si normë dhe që i gjejmë gjithandej, që nga dokumentacioni shkencor, te veprat e tekstet shkencore e deri te botimet shkencore popullore, që në ditët e sotme janë aq të shumta.

Përfundime

Leksikografia bashkëkohore ka përcaktuar kritere të qarta për vlefshmërinë e një fjalori. Nga sa më sipër këto kritere janë plotësuar në shkallë të lartë nga “Fjalori Shpjegues i Psikanalizës”. Si i tillë, ai mban me plot të drejtë cilësimin fjalor bashkëkohor. Por, leksikografia bashkëkohore ka përcaktuar edhe kritere të tjera që u rrinë ballë kritereve të lartpërmendura, dhe ato janë: a është letra e cilësisë së lartë, a e mundëson lidhja e fjalorit hapjen e lehtë të faqeve të tij, a janë theksuar veçantë dhe qartë artikujt e fjalorit, a siguron fjalori komoditet pamor, etj. Edhe këto kritere ky fjalor i përmbush në shkallë të lartë.

Fjalorët si ky që kemi në dorë nuk përfundojnë kurrë. *Fjalori Shpjegues i Psikanalizës* i çeli rrugën edhe hartimit nga i njëjti autor të *Leksikonit të psikologjisë*^[7] në 2 vëllime, në vitin 2014. Pasurimi dhe plotësimi i terminologjisë shqipe të psikanalizës do të vazhdojë edhe në vitet që do të vijnë, edhe nga breza të tjerë, sa të ekzistojë shqipja.

Referenca

- [1] Merxhani, B., “*Pesë leksione të psikanalizës*”, 1938.
- [2] Nushi, P., *Fjalor shpjegues i psikanalizës, Hyrje*, ASHAK, Prishtinë, 2010, fq. 8.
- [3] Shih për më me hollësi Proko, V. & Cakaj, N. & Mërtiri, I., *Bibliografi e terminologjisë në “GJENDJA DHE ZHVILLIMI I TERMINOLOGJISË SHQIPE – PROBLEME DHE DETYRA” (Monografi të botuara; Konferenca shkencore dhe përmbledhje artikujsh; Monografi të pabotuara dhe mastera të mbrojtura; Recensione në revista shkencore; Artikuj shkencorë; Fjalorë terminologjikë*, ASHSH & ASHAK, Tiranë 2009, fq. 243–294.
- [4] Nushi, P., “Fjalor i psikologjisë”, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1987.
- [5] Proko, V., *Probleme te depërtimit dhe të ngulitjes së anglicizmave në nivele të ndryshme të ligjëritimit*, në Konferencën II Shkencore Ndërkombëtare: “KËRKIME GJUHËSORE”, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Qendra e Studimeve Albanologjike, korrik, 2013, Tiranë, 2014.
- [6] Brener, Ç., “*Themelet e psikanalizës*”, UFO Pres, Tiranë, 2008; Eysenck, H. J., “*Uses and Abuses of Psychology*”, Penguin Books Ltd, Hamondsworth, Middlesex, 1953; Laplanche, J.– Pontalis, J., “*Vocabulaire de la Psychoanalyse*, Presses Universitaires de France, 1967, Paris; Xhuvani, A., “*Fillime të pedagogjisë*”, pjesë e shtime në punë të edukatës për shkollat normale e për mësuesit e filloreve, Shtëpia botonjëse “Luarasi”, Tiranë, 1933; Nushi, P., “*Psikologjia e përgjithshme 2, Njeriu dhe personaliteti i tij në psikologji*, Prishtinë, 1999; Nushi, P., “*Psikologjia e personalitetit dhe terminologjia e saj*”, në “GJENDJA DHE ZHVILLIMI I TERMINOLOGJISË SHQIPE – PROBLEME DHE DETYRA”, ASHSH & ASHAK, Tiranë 2009, fq. 243–294.
- [7] Nushi, P., “*Leksikon i psikologjisë*”, ASHAK, Prishtinë, 2014.



Viti i X^{-të} | Botimit, Nr.2,
Dhjetor 2019

UDHËZIME PËR AUTORËT

Materialet (artikujt) i adresohen revistës *OPTIME*. Ato i nënshtrohen vlerësimit të redaksisë, e cila miraton për botim, pasi ka bërë modifikimet eventuale.

Materiali i dërgohet sekretariatit të redaksisë së *Albanian University* në adresën *Bulevardi Zogu I, Tiranë, znj. Eglantina Dervishi, email: egladervishi@yahoo.com dhe Erda Qorri, email: erdaqorri@gmail.com*

Materiali dorëzohet në 3 kopje (një origjinal dhe 2 fotokopje), si dhe në formën elektronike (me disketë). Ai duhet të shoqërohet me adresën e email-it të autorit me të cilin do të lidhet redaksia në vazhdim. Po ashtu, dorëzohet një formular, i cili duhet të firmoset nga autorët e tjerë që i delegojnë autorit kryesor kompetencat. Autorësia nënkupton që secili autor të këtë marrë pjesë në mënyrë të mjaftueshme në punim, aq sa të marrë përgjegjësi publike për përmbajtjen e tij. Renditja e autorëve përcaktohet nga vendimi i përbashkët i bashkautorëve.

Pasi kthehet materiali për rregullime nga autori/autorët, ai ridërgohet në formën përfundimtare.

Drejtskrimi i gjuhës shqipe është i detyrueshëm. Nuk pranohet zëvendësimi i shkronjës **ë** dhe **ç**, përkatësisht me shkronjat **e** dhe **c**.

Materiali duhet të renditet sipas kësaj mënyre:

Faqja e titullit përmban:

Titullin

Emrin /emrat e autorëve (pa titujt shkencorë)

Adresat e të gjithë autorëve. Kur autorët janë në qendra të ndryshme pune, djathtas tyre bëhet një shenjë (që specifikohet më poshtë), p.sh.:

Emër Mbiemër *, Emër Mbiemër **, Emër Mbiemër ***

* Albanin University

** Fakulteti i Mjekësisë i UT

*** Ministria e Shëndetësisë

Adresa e plotë (përfshirë telefonin dhe email-in) e autorit që do të mbajë lidhje me revistën.

Abstrakti

Paraqitet në shqip dhe në versionin anglisht dhe përmban jo më shumë se 250 fjalë. Abstraktit në anglisht i vihet edhe titulli. Në abstrakt paraqitet qëllimi, metodat, rezultatet dhe përfundimet.

Poshtë abstraktit shkruhen fjalët kyçe. P.sh.:

Fjalë Kyçe: revistë, artikull, psikologji.

Materiali

Gjatë shtjellimit të materialit çdo referencë, figurë dhe tabelë numërohet në shifra arabe me numër rendor sipas rendit që citohen në tekst. Kur janë më shumë se 2 referenca, ato ndahen me presje).

Nuk përdoren shkurtime të tjera përveç atyre që janë përdorur në abstrakt.

Falënderimet, nëse ka, shtypen në mbarim të tekstit, pas referencave.

Referencat

Referencat shënohen në tekst me numërorë arabe sipas rendit që citohen.

Referencat shtypen në fletë të veçanta nga teksti me hapësirë dyfishe sipas stilit *Vancouver* (International Committee of Medical Journal Editors Uniform requirements for manuscripts submitted to biomedical journals). Kur lista e autorëve përbëhet nga 1 deri në 7 vetë, citohen që të gjithë. Kur ajo përmban më shumë se 7 vetë, citohen vetëm 3 të parët dhe pas të tretit, shënohet fjala et al. (ose me shkurtimin shqip *e bp.*).

Referencat përshkruhen si më poshtë:

1. Referenca e artikujve periodikë

Autorët ,Titulli, Revista, viti, volumi, faqe, p.sh. :

(1) Quilici J., Gallo R. Physiopatologie des syndromes coronariens aigus. Ann Cardiol. Angeiol 2009;148;611-23.

2. Referenca e një libri

Autori. Titulli, Vendi i botimit, Shtëpia botuese, Viti i botimit.

P.sh.:

(2) Cohen J. Return extrasystoles. New York; Grune and Stratton; 1996.

3. Referenca e një kapitulli libri

Autori kapitullit. Emri kapitullit. Emri i autorit të librit Emri i librit. Vendi i botimit. Shtëpia botuese. Viti botimit; faqet e kapitullit.

P.sh.:

(3) Baillet J. L'apport de la scintigraphie dans le diagnostic de l'embolie pulmonaire. Në: Chiche P La maladie thrombo-embolique pulmonaire Paris; L'Expansion scientifique française; 1969, f. 107-34.

Shkrimet që nuk u përmbahen këtyre udhëzimeve do t'u rikthehen autorëve për rishikim pa u marrë në shqyrtim.

Redaksia